



Pranuar / Dorezuar Punë/Produkt Received/Delivry	23. 06	2022	2	viti god year
Organ /Njësia Org /Jednica Org /Unit	Nr Prot Bj Prot Prot No	Shtojca Pislog Appendix	Sasia Kolicina Quantity	
SKPM/SHCK	3677/2022		1/10	



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.432/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Jeton Koca-kryetar, Ardita Haxhnikaj-Demi dhe Arben Mehmeti-anëtarë, dhe Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.432/2022 të datës 29.04.2022 të parashtruar nga ankuesi [redacted] të cilin me autorizim e përfaqëson [redacted] me adresë rruga [redacted] kundër Vendimit me Nr.579/2022 të datës 08.04.2022 të Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Punëve të Brendshme, në çështjen juridike "Largim nga Shërbimi Civil", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.3 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datën 23.06.2022, mori këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet pjesërisht si e bazuar ankesa me numër A.nr.432/2022 e datës 29.04.2022 e parashtruar nga ankuesi
- II. Ndryshohet Vendimi me Nr.579/2022 i datës 08.04.2022 i Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Punëve të Brendshme lidhur me masën disiplinore ndaj ankuesit nga masa disiplinore "Largim nga Shërbimi Civil", në masën disiplinore "Ndalimi i ngritjes në detyrë, duke përfshirë këtu rritjen në shkallën e pagës për një periudhë prej tri viteve".
- III. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Punëve të Brendshme, që brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, të kthejë ankuesin në vendin e punës Drejtor i Departamentit për Standarde dhe Politika të Inxhinieringut dhe Menaxhimit të Ndërtesave Qeveritare, sipas Akt Emërimit të datës 03.10.2016, me të gjitha të drejtat dhe detyrimet nga marrëdhënia e tij e punës.
- IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim lidhur me veprimet e ndërmarra për zbatimin e këtij vendimi.

Arsyetim

Ankuesi, [redacted] i punësuar në pozitën e punës *Drejtor i Departamentit për Standarde dhe Politika të Inxhinieringut dhe Menaxhimit të Ndërtesave Qeveritare (DSPIMNQ)*, pranë Ministrisë së Punëve të Brendshme, përmes përfaqësuesit të autorizuar [redacted] me datë 29.04.2022 ka parashtruar ankesë me numër protokolli:2521/2022 të regjistruar me numër A.nr.432/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me Nr.579/2022 të datës 08.04.2022 të Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Punëve të Brendshme, me të cilin ankuesit i është shqiptuar masa disiplinore "*Largim nga Shërbimi Civil*".

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil i Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 13.05.2022 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesën, ndërsa më datë 23.05.2022 ka pranuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Kryetari i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 09.06.2022 ka nxjerr Vendimin me numër VK.nr.56/2022 për shtyrje të afatit për vendosje të ankesës së ankuesit për 10 ditë pune.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova: Ankesën me Nr. Prot:2521/2022 të regjistruar me numër A.nr.432/2022 e datës 29.04.2022 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me Nr.579/2022 të datës 08.04.2022 të Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Punëve të Brendshme; Kërkesën për inicimin e procedurës disiplinore e datës 18.11.2021; Vendimin me Nr. 408/2022 i datës 17.03.2022; Procesverbali i seancës së Komisionit Disiplinor i datës 04.04.2022; Procesverbalin i komisioni për shoqërim të ankuesit në arkiva të dokumenteve i datës 29.03.2022; Emailin e datës 27.01.2022; Emailin e datës 23.03.2021; Emailin e datës 23.03.2022, 14.09.2021, 16.08.2021 nga [redacted] Emailin e datës 22.03.2022 nga [redacted] Emailin e datës 20.04.2021 nga [redacted] Emaili e datës 14.04.2021 nga ankuesi; Emailin e datës 13.04.2021 nga [redacted] Emailin e datës 13.04.2021 dhe 03.09.2021 nga ankuesi; Emailin e datës 02.09.2021 nga [redacted] Kërkesën për përshpejtimin e procedurave për mirëmbajtjen higjienike të kompleksit Rilindja e datës 16.09.2021; Deklarata e Nevojave dhe përcaktimin të disponueshmëri së fondeve e datës 16.08.2021; Kërkesën për iniciimi për prokurim e datës 16.08.2021; Emailin e datës 09.11.2021, 08.11.2021 nga ankuesi; Emailin e datës 08.11.2021 nga [redacted] Emailin e datës 11.11.2021 nga ankuesi; Emailin e datës 10.11.2021 nga [redacted] Emailin e datës 10.11.2021 nga [redacted] Emailin e datës 09.11.2021 nga [redacted] Emailin e datës 09.11.2021 nga [redacted] Emailin e datës 13.04.2021, 01.04.2021, 20.04.2021 nga [redacted] Emailin e datës 14.04.2021 nga ankuesi; Emailin e datës 23.06.2021 nga [redacted] Emailin e datës 23.06.2021, 02.06.2021 nga ankuesi; Emailin e datës 03.08.2021 nga [redacted] Emailin e datës 03.08.2021 nga [redacted] Emailin e datës 03.08.2021 nga [redacted] B.Dobra; Emailin e datës 05.08.2021 nga [redacted] Emailin e datës 05.08.2021 nga [redacted] Emailin e datës 05.08.2021 nga [redacted] për ankuesin; Emailin e datës 17.11.2021, 14.04.2021 nga ankuesi për [redacted] Emailin e datës 25.05.2021 nga [redacted] për ankuesin; Emailin e datës 11.11.2021 nga [redacted] për [redacted] Plani i veprimit të Menaxhimit viti 2021 nga Njësia e Auditimit të Brendshëm në MPB; Emailin e datës 28.10.2021 nga ankuesi për [redacted] Emailin e datës 18.10.2021 nga [redacted] Emailin e datës 11.10.2019 nga ankuesi për [redacted] Emailin e datës 10.10.2019 nga ankuesi; Raporti i Auditimit nga Njësia e Auditimit të Brendshëm me kërkesë

të ministrit; Raporti i Auditimit të Performancës nga Zyra Kombëtare e Auditimit për Menaxhimin e Kontratave publike të ndërtimit tetor 2019; Letër konfirmimi i datës 10.10.2019; Emailin e datës 25.06.2020 nga ankuesi; Raport i komisionit të vlerësimit për ofertën e punëve shtesë të paparapara për kontratën me titull Lot 10 Ndërtimi i Ndërtesës së IKAP-it-Prishtinë; Emailin e datës 15.11.2019 nga ankuesi; Raporti i Punëve shtesë dhe të Paparaparë i datës 14.06.2021; Kërkesë për zgjatjen e afatit për kryerjen e punimeve e datës 30.12.2019; Emailin e datës 07.10.2021 për [redacted] Emailin e datës 20.10.2021 nga ankuesi për [redacted] Emailin e datës 07.10.2021 nga [redacted] për [redacted] Emailin e datës 08.11.2021 nga aneksi për [redacted] Emailin e datës 11.11.2021 nga ankuesi për [redacted] dhe [redacted] Emailin e datës 07.10.2021 nga ankuesi për [redacted] dhe [redacted] Emailin e datës 09.11.2021 nga [redacted] për [redacted] Emailin e datës 09.11.2021 nga [redacted] për [redacted] Emailin e datës 01.11.2021 nga [redacted] për ankuesin dhe [redacted] Emailin e datës 15.10.2021 nga [redacted] për ankuesin dhe [redacted] Emailin e datës 17.11.2021 nga [redacted] për ankuesin; Emailin e datës 27.10.2021 nga ankuesi për [redacted] Emailin e datës 27.10.2021 nga [redacted] për ankuesin; Emailin e datës 27.10.2021 nga [redacted] Emailin e datës 22.09.2021 nga [redacted] për [redacted] dhe [redacted] Emailin e datës 21.10.2021 nga [redacted] Emailin e datës 27.10.2021 nga [redacted] për ankuesin; Provë për kërkesat e pranuar për vitin 2021; Kërkesë për përgjigje në ankesë e datës 13.05.2022; Përgjigjen në ankesë e datës 23.05.2022; Përshkrimin e detyrave të punës për Drejtor DSPIMNQ; Marrëveshje Mirëkuptimi ne mes të MAP dhe Komunës së Lipjanit e datës 08.03.2017; Vendimin me Nr. 1143/2021 i datës 26.10.2021 për themelimin të komisionit për vlerësimin-negocimin e tenderit "ndërtimi i shkollave dhe ndërtesës së IKAP-it Lot 1; Raportin e vlerësimit të tenderëve i datës 04.11.2021; Njoftim për Komisionin Rregullativ të Prokurimit Publik i datës 13.07.2021; Ri-kërkesë për iniciimin e procedurave të prokurimit për punë shtesë dhe të paparapara "Impianti për trajtimin e ujerave të zeza ITUZ në bllokun urban "Prishtina e Re" e datës 21.07.2021; Ri-kërkesën për iniciim të procedurave të prokurimit për punë shtesë për projektin "Ndërtimi i ndërtesës së IKAP-it datë 16.07.2021; Plani i veprimtimit të Menaxhmentit nga DSPIMNQ për vitin 2021; Planifikimi përfundimtar i prokurimit datë 21.09.2021; Kërkesën për përshpejtimin e procedurave për Mirëmbajtjen e Higjienës të Kompleksit Rilindja e datës 15.09.2021; Procesverbalin e Komisionit Disiplinor i datës 29.03.2022, 25.03.2022, 24.03.2022; Emailin e datës 14.04.2022 nga [redacted] për [redacted] Ftesë për seancë e datës 01.04.2022 nga Personeli MPB ; Emailin e datës 29.03.2022 nga ankuesi për personeli MPB; Ankesën me Nr. Prot:6445/2021 të regjistruar me numër A.nr.1234/2021 e datës 31.12.2021 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Akt Emërimit e datës 03.10.2016 për ankuesin; Ftesën për seancë disiplinore e datës 02.12.2021; Vendimin me Nr.1425/2021 të datës 17.12.2021 të Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Punëve të Brendshme; Procesverbali e Komisionit Disiplinor i datës 06.12.2021; Emailin e datës 17.12.2021 nga [redacted] për Personelin e MPB; Emailin e datës 16.12.2021 nga Personeli i MPB për Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 18.01.2022; Përgjigjen në ankesë e datës 02.02.2022; Emailin e datës 19.11.2021 nga Personeli MPB për ankuesin; Vendimin e datës 19.11.2021 të Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Punëve të Brendshme; Procesverbalin e datës 19.11.2021 të Komisionit Disiplinor; Formularin për vlerësimin e rezultateve në punës i datës 20.12.2019; Aktgjykimin e datës 02.02.2016 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Ekonomike; Njoftimin për përdorimin e procedurës së negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë i datës 13.07.2021; Kërkesë për përzgjedhjen e OR për Mirëmbajtjen Higjienike të Kompleksit Rilindja e datës 16.08.2021; Vendimin VK.nr.13/2022 i datës 11.02.2021 për shtyrje të afatit për vendosje; Vendimin A.nr.1234/2021 i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin

Civil të Kosovës; Vendim me numër VK.nr.56/2022 të datës 09.06.2022 të Kryetarit të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët, konstatoi se ankesa e ankuesit është **pjesërisht e bazuar, SEPSE:**

Bazuar në shkesat e lëndës, gjegjësisht Akt Emërimit të datës 03.10.2016 është konstatuar se ankuesi është i punësuar në pozitën e punës *Drejtor i Departamentit për Standarde dhe Politika të Inxhinieringut dhe Menaxhimit të Ndërtesave Qeveritare (DSPIMNQ)* në Ministrinë e Administratës Publike, tani Ministria e Punëve të Brendshme.

Zëvendësuesja e Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Punëve të Brendshme, më datë 18.11.2021 ka parashtruar kërkesë për fillimin e procedurës disiplinore ndaj ankuesit për shkak të mos përmbushjes së detyrave të punës, mos respektim i afatet të caktuar në përmbushjen e detyrave të punës, dhe moszbatim të dispozitave ligjore për përmbushjen e detyrave funksionale si dhe shkeljen e detyrimeve të përcaktuar me legjislacionin në fuqi në kuptim të nenit 46 paragrafi 3 nën paragrafi 1, 2, 3 dhe 10 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë.

Komisioni Disiplinor i Ministrisë së Punëve të Brendshme, me Vendimin me Nr.1259/2021 të datës 19.11.2021 ankuesin e ka pezulluar nga ushtrimi i detyrës, ndërsa me Vendimin me Nr.1425/2021 të datës 17.12.2021, të njëjtit i ka shqiptuar masën disiplinore "*Largim nga Shërbimi Civil*", kundër të cilit vendim ankuesi kishte parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore se Komisioni Disiplinor i Ministrisë së Punëve të Brendshme, me rastin e shqiptimit të masës disiplinore ndaj tij kishte bërë shkelje të dispozitave procedurale dhe dispozitave të ligjit material.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me Vendimin A.nr.1234/2021 të datës 28.02.2022 ka aprovuar ankesën e ankuesit si të bazuar, ka shfuqizuar Vendimin me Nr.1425/2021 të datës 17.12.2021 të Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe rrjedhimisht lëndën e ka kthyer në rishqyrtim dhe rivendosje të Komisioni Disiplinor, për shkak të shkeljeve procedurale dhe të metave ligjore të aktit të kontestuar. Komisioni Disiplinor i Ministrisë së Punëve të Brendshme, në zbatim të Vendimit A.nr.1234/2021 të datës 28.2.2022, ka ri-shqyrtuar lëndën e ankuesit dhe më datë 08.04.2022 ka nxjerr Vendimin me Nr.579/2022 me të cilin ankuesit i ka shqiptuar masën disiplinore "*Largim nga Shërbimi Civil*".

Kundër Vendimit me Nr.579/2022 të datës 08.04.2022 të Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Punëve të Brendshme, ankuesi me datë 29.04.2022 ka parashtruar përsëri ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimin ankimor se vendimi për shqiptimin e masës disiplinore ndaj tij është nxjerr përmes shkeljeve të dispozitave procedurale dhe dispozitave të ligjit material, nën supozimin se Komisioni Disiplinor nuk ka arritur të konstatoi në mënyrë të plotë dhe të drejtë gjendjen faktike duke e bërë përgjegjës ankuesin për veprimet të cilat pretendon se nuk i ka bërë, dhe nuk ka konstatuar në mënyrë të drejtë elementet e shkeljes disiplinore.

Lidhur me pretendimet ankimore të ankuesit, Kolegji i Këshillit analizoi Vendimin me Nr.579/2022 të datës 08.04.2022 të Komisionit Disiplinor, dhe si rrjedhojë gjeti se ky komision ka shpallur përgjegjës ankuesin lidhur me parregullsitë në procedurat e prokurimit për mirëmbajtje higjienike të iniciuara nga Departamenti për Standarde dhe Politika të Inxhinieringut dhe Menaxhimit të Ndërtesave Qeveritare (DSPIMNQ), pas konstatimit se Planifikimi Përfundimtar i

Prokurimit për vitin 2021, me numër rendor 35 të datës 21.01.2021, pika II.2 me numër rendor 99, parasheh se në muajin qershor 2021 të iniciohet kontrata me titullin "Mirëmbajtja higjienike e ndërtesave Qeveritare" për kompleksin e "Rilindjes", dhe se Zyrtari i Lartë për Menaxhimin e Mirëmbajtjes së Sistemeve ka iniciuar kërkesë më datë 29.07.2021 për prëzgjedhjen e operatorin ekonomik për "Mirëmbajtjen Higjienike të Kompleksit Rilindja", dhe i njëjti ketë kërkesë e ka përsëritur më datë 16.08.2021, ndërsa ankuesi kërkesën e ka nënshkruar me datë 06.09.2021. Ankuesi, në seancën e Komisionit Disiplinor është deklaruar se: "Nga asistentja e Sekretarit të Përgjithshëm të MPB-se është kërkuar te pezullohen dhe te mos fillohet asnjë procedure e prokurimit". Rrjedhimisht, Komisioni Disiplinor ka konstatuar se ankuesi si Drejtor i DSPIMNQ-se (bazuar nenin 19 paragrafi 3 të Ligjit për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura) për aktivitetet e prokurimit në fjalë është njësi e kërkesës dhe është përgjegjës për shkelje të afateve të përcaktuara në Planifikimin Përfundimtar të Prokurimit për vitin 2021 të MPB-së, duke iniciuar kërkesën për procedurë të prokurimit për "Mirëmbajtje higjienike të kompleksit Rilindja" me vonesë për rreth tre muajve në kundërshtim me nenin 8 paragrafi 1 të Ligjit të Prokurimit Publikë dhe nenit 10 paragrafi 10.1 (a) të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik (RRUOPP). Andaj, me moszbatimin e Planit të Prokurimit i paraparë në muajin qershor 2021, ka venë në pozitë jo të mirë MPB-në që të mbes pa ofrim të mirëmbajtjes higjienike, në periudhën e pandemisë.

Kolegji i Këshillit lidhur me konstatimin e Komisionit Disiplinor për parregullsitë në procedurat e prokurimit për mirëmbajtje higjienike të iniciuara nga Departamenti i Standardeve për Politikën e Menaxhimit të Ndërtesave Qeveritare, gjegjësisht tejkalinin e afateve në realizimin e aktiviteteve, analizoi përshkrimin e detyrave të punës së këtij departamenti: "Udhëheq politikën e planifikimit në fushën e infrastrukturës së ndërtesave qeveritare konform Ligjit për Planifikim Hapësinor, Ligjit të Ndërtimit dhe ligjeve tjera në fuqi në Republikën e Kosovës; Harton strategji për implementimin e prioritetëve shtetërore në fushën e infrastrukturës së ndërtesave qeveritare; Udhëheqës zbatimin e strategjive të fushës së Infrastrukturës së ndërtimeve në harmoni me Ligjin e Ndërtimit dhe ligjet tjera në fuqi në Republikën e Kosovës; Udhëheqë me tërë infrastrukturën e ndërtesave qeveritare brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Kosovës; Harton standarde teknike mbi format e shfrytëzimit të ndërtesave qeveritare nga institucionet përkatëse", dhe rrjedhimisht duke iu referuar dispozitave të Ligjit Nr.04/L-042 për Prokurimin Publikë në Republikën e Kosovës, konstatoi se ky departament bashkëpunon ngushtë më Zyrën e Prokurimit për aktivitete të caktuara të prokurimit, dhe Zyrtarin Kryesor Administrativ, për punën e gjithmbarshme nga fushë veprimtaria e tij, kështu që Kolegji i Këshillit vlerëson se vonesa në afatet e aktiviteteve nuk ka qenë në mënyrë ekskluzive në përgjegjësinë e këtij departamenti, dhe se Komisioni Disiplinor në secilin rast është dashur të ketë pasur parasysh Ligjin Nr.04/L-042 për Prokurimin Publikë në Republikën e Kosovës, përkatësisht nenin 24 paragrafi 1 të këtij ligji ku përcaktohet se: "Të gjitha aktivitetet e prokurimit janë përgjegjësi e autoritetit përkatës kontraktues pavarësisht nga shpërndarja e detyrave brenda autoritetit kontraktues sipas nenit 22 të këtij ligji. Rrjedhimisht, në kuptim të kësaj, Kolegji i Këshillit në shkresa të lëndës ka gjetur Njoftimin e datës 23 mars 2021 të dërguar nga Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm, në adresë të ankuesit, më përmbajtjen ku është theksuar se: "Po ju shkruaj në emër të Sekretarit, ju lutem që të pezulloni dhe të mos filloni asnjë procedurë të prokurimit", ndërsa sipas vendimit të kontestuar Komisioni Disiplinor nuk e ka marrë parasysh ketë si fakt gjatë administrimit të provave, gjegjësisht gjatë konstatimit të përgjegjësisë disiplinore të ankuesit, duke vepruar kështu në kundërshtim me dispozitat e nenit 48 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 dhe 1.5 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative. Andaj, bazuar si me lartë Kolegji i Këshillit

konstaton se Komisioni Disiplinor me rastin e trajtimit të kërkesës se iniciuar disiplinore lidhur me çështjen e tejkalimit të afateve në procedurat e prokurimit lidhur me kontratën me titullin "Mirëmbajtja higjienike e ndërtesave Qeveritare" për kompleksin e "Rilindjes", nuk ka konstatuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë gjendjen faktike, dhe si rrjedhojë gabimisht ka zbatuar ligjin material me rastin e shpalljes përgjegjës të ankuesit sepse Kolegji i Këshillit vlerëson se Komisioni Disiplinor është dashur të marrë parasysh si provë vendimtare *Njoftimin e datës 23 mars 2021 të dërguar nga Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm*, sepse Sekretari i Përgjithshëm është nëpunësi më i lartë civil i ministrisë, përgjegjës për drejtimin e të gjithë veprimtarisë administrativo-profesionale të sistemit ministror siç parashihet me dispozitat e Ligjit Nr.06/L-113 për Organizimin dhe Funkcionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, përkatësisht nenit 18 paragrafi 1 dhe 3 ku përcaktohet se: 1. Sekretari i Përgjithshëm është nëpunësi më i lartë civil i ministrisë, përgjegjës për drejtimin e të gjithë veprimtarisë administrativo-profesionale të sistemit ministror. 3. *Sekretari i Përgjithshëm ka këto përgjegjësi kryesore* 3.1. mbështet ministrin në punën e tij; 3.2. siguron koordinimin e hartimit të politikave në ministrinë përkatëse; 3.3. siguron zbatimin dhe kontrollin e zbatimit të legjislacionit, të politikave dhe të vendimeve të ministrit; 3.4. *siguron drejtimin, koordinimin, kontrollin dhe mbikëqyrjen e të gjithë sistemit ministror*; 3.5. siguron bashkëpunimin me ministri të tjera dhe institucionet, si dhe me agjencitë e pavarura; 3.6. *vendos për administrimin e burimeve financiare, materiale dhe njerëzore, të sistemit ministror, në përputhje me legjislacionin në fuqi*; 3.7. çdo përgjegjësi tjetër, që i caktohet me ligj apo të deleguar shprehimisht nga ministri.

Iniciuesi i procedurës disiplinore, po ashtu pretendon se ankuesi është përgjegjës lidhur edhe me çështjen e mos përmbushjes së detyrave funksionale dhe shkeljen e detyrave të përcaktuara me legjislacionin në fuqi, duke ju referuar Raportit të Auditimit me titull "*Menaxhimi i kontratave publike të ndërtimit nga DSPIMNQ 2016/2018*" i kryer nga Njësia e Auditimit të Brendshëm në MPB (Nr.754 të datës 20.10.2021), në të cilin raport janë identifikuar si të gjetura humbja e kontesteve gjyqësore dhe mos ofrimi i sigurisë për parane e shpenzuar.

Komisioni Disiplinor, bazuar në provat e administruara ka konstatuar se humbja e kontesteve gjyqësore nuk është përgjegjësi e ankuesit, siç pretendon iniciuesi i procedurës disiplinore dhe rrjedhimisht lidhur me këtë çështje ky komision ka konstatuar se nuk ka elemente të mos përmbushjes së detyrave të punës nga ankuesi.

Ndërsa, lidhur me pretendimin e iniciuesit të procedurës disiplinore për shkeljen e detyrave të punës nga ankuesi, për shkak të inicimit të procedurës së prokurimit pa aprovim paraprak nga hartuesi i projektit dhe Zyrtari Kryesor Administrativ, Komisioni Disiplinor duke ju referuar Raportit të Auditimit të Brendshëm, Nr.754 të datës 20.10.2021, me titull "*Menaxhimi i kontratave publike të ndërtimit nga DSPIMNQ 2016/2018*" ka konstatuar se ankuesi është përgjegjës për shkelje disiplinore për shkak se lidhur me kontratën me titull: *Llot 10-Ndertimi i ndërtesës së IKAP-it, Prishtinë*, i njëjti në cilësinë e Drejtorit të DSPIMNQ-se, ka lejuar që zyrtaret e tij pa aprovim nga Zyrtari Kryesor Administrativ, të vlerësojnë dhe negociojnë punë shtesë dhe çmime me operatorin ekonomik në cilësinë e komisioneve, respektivisht ka krijuar, lejuar dhe aprovuar raportin e komisionit pa aprovim paraprak nga Zyrtari Kryesor Administrativ, duke vepruar në kundërshtim me Rregullat dhe Udhëzuesin Operativ për Prokurimin Publikë, përkatësisht nenin 9 "*Funksionet e Zyrtarit Kryesor Administrativ*" paragrafi 9.1 "*Zyrtari Kryesor Administrativ do të ketë përgjegjësinë e përgjithshme*" pika "j" "*për provimin e anëtarëve të Komisionit të Vlerësimit të Tenderëve*", neni 40 "*Krijimi i Komisioneve Vlerësuese të Tenderëve*" dhe paragrafi 40.1 citojmë "*Duke ju referuar*

nenit 59 paragrafi 1 i LPP-së, për të gjitha aktivitetet e prokurimit AK, respektivisht "ZKA" në bashkëpunim të ngushtë me zyrtarin përgjegjës të prokurimit duhet të krijoj një komision të vlerësimit të tenderëve me funksione krejtësisht këshillues për Zyrtarin përgjegjës të Prokurimit. Nga ky rregull përjashtohen aktivitetet e prokurimit me vlerë minimale. Zyrtari përgjegjës i Prokurimit do të bëjë rekomandimin për anëtar të Komisionit të Vlerësimit të Tenderëve për ZKA, i cili do të aprovoj të gjitha nominimet ose kur është e nevojshme do të zgjedh anëtarë alternativ për Komisionin. Anëtarët e komisionit të hapjes së tenderëve mund të shërbejnë si anëtar të komisionit të vlerësimit".

Kolegji i Këshillit, lidhur me këtë çështje ka analizuar dosjen e lëndës dhe rrjedhimisht duke ju referuar provave të administruara, ka gjetur se ankuesi gjatë seancës së Komisionit Disiplinor ka pranuar se në cilësinë e Drejtorit të DSPIMNQ-së ka krijuar komisione profesionale, mirëpo i njëjti në deklarin e tij thekson se këto komisione nuk themelohen për negociim të çmimit, por vetëm për vlerësimin e nevojës për punë shtesë dhe vlerën e punëve shtesë. Ndërsa kryesuesja e njërit nga këto komisione znj. [redacted] në seancën e Komisionit Disiplinor ka deklaruar se komisioni të cilin e udhëhiqte ajo është themeluar përmes e-mailit nga Drejtori i DSPIMNQ-së, në këtë rast ankuesi, dhe se e njëjta në pyetjen e Komisionit Disiplinor se a i negocioni çmimet me operatorin ekonomik, ajo ka deklaruar se "ne i negociojmë-përafrojmë çmimet me të tregut siç shihet në ofertë, kjo është llogari preliminare. Këto janë dërguar në prokurim dhe ata mund të krijojnë komision tjetër, ta ftojne operatorin ekonomik për të vlerësuar ofertën, çmimet dhe ky komision mund të negocioj për ulje/ngjitje të ofertës". Po ashtu, Kolegji i Këshillit në shkresë të lëndës ka gjetur edhe dëshminë e dëshmitarit [redacted] anëtar i njërit nga komisionet e themeluar nga ankuesi i cili ka pohuar se "ne rastin tim janë negociuar çmimet, mirëpo kanë qenë çmime të tregut, për fazat tjera nuk e di sepse nuk lidhet me profesionin tim (hidro).

Ndërlidhur me këtë, Kolegji i Këshillit ka gjetur se z. [redacted] Drejtor i Njësisë së Auditimit të Brendshëm në MPB, në seancën e Komisionit Disiplinor ka deklaruar se njësisë kërkuese ka të drejtë të formoj komisione, por jo komisione për të zhvilluar procedura të negociimit dhe vlerësimit, sepse ky komision zgjidhet me procedura tjera, me tej i njëjti shton se për të gjeturën 6, faqe 19 është pajtuar edhe DSPIMNQ-ja.

Andaj, bazuar si me sipër, Kolegji i Këshillit vlerëson se konstatimi i Komisionit Disiplinor, lidhur me çështjen e krijimit, lejimit, si dhe aprovimit të raportit të komisionit pa aprovim paraprak nga Zyrtari Kryesor Administrativ, e gjetur kjo edhe në Raportin e Auditimit të Brendshëm Nr.754 të datës 20.10.2021, me titull "Menaxhimi i kontratave publike të ndërtimit nga DSPIMNQ 2016/2018", është i drejtë dhe i ligjshëm, për faktin se me Rregullat dhe Udhëzuesin Operativ për Prokurimin Publikë, themelimi i komisioneve të vlerësimit është nën përgjegjësinë e Zyrtarit Kryesor Administrativ. Rrjedhimisht, Kolegji i Këshillit, konstaton se Komisioni Disiplinor ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike dhe bazën juridike, me rastin e përcaktimit të përgjegjësisë së ankuesit lidhur me çështjen e lejimit të komisioneve për negociim të çmimeve dhe aprovimin e raporteve të komisioneve përkatëse.

Komisioni Disiplinor, në këtë çështje disiplinore, gjegjësisht në Vendimin me Nr.579/2022 të datës 08.04.2022 i është referuar edhe Raportit të Auditimit të Performances të Zyrës Kombëtare të Auditimit (ZKA), të muajit tetor 2019 në lidhje me menaxhimin e kontratave publike të ndërtimit në tri organizata buxhetore: Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT), ish Ministrinë e Administratës Publike (MAP) dhe Ministrinë e Rinisë, Kulturës dhe Sportit (MRKS) për vitin 2016-2018, dhe si rrjedhojë vetëm ka ri përshkruar disa nga dobësitë e identifikuara në

procesin e menaxhimit të kontratave të ndërtimit në tri organizatat buxhetore të audituara, por sipas vlerësimit të Kolegjit të Këshillit, Komisioni Disiplinor nuk ka arritur që në mënyrë konkrete të konstatoi përgjegjësinë e ankuesit, në lidhje me të gjeturat e raportit të auditimit në fjalë dhe në këtë rast ka dështuar të konstatoi në mënyrë të plotë dhe të drejtë gjendjen faktike, dhe si rrjedhojë gabimisht ka zbatuar ligjin material me rastin e shpalljes përgjegjës të ankuesit dhe shqiptimit të masës disiplinore sipas Ligji Nr.06/L-114 për Zyrtaret Publike, sepse raportet e auditimit i referohen periudhës 2016-2018, ndërsa, Ligji për Zyrtaret Publikë është i zbatueshëm nga data 09.07.2020, dhe i njëjti nuk ka fuqi retroaktive.

Kolegji i Këshillit po ashtu duke ju referuar Vendimit me Nr.579/2022 të datës 08.04.2022 ka gjetur se ankuesi është shpallur përgjegjës edhe në lidhje me për moszbatimin e rekomandimeve të dhëna nga Njësia e Auditimit të Brendshëm, duke ju referuar Raportit të auditimit me titull "Menaxhimi i kontratave publike të ndërtimit nga DSPIMNQ 2016/2018, i kryer nga NJAB/MPB me datë 20.10.2021". Ndërlidhur me këtë, Kolegji i Këshillit ka shqyrtuar Raportin e Auditimit si dhe Planin e Veprimit të Menaxhmentit, por nuk ka gjetur se ankuesi është i ngarkuar drejtpërdrejtë si person përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve të Raportit të Auditimit. Andaj, në kuptim të dispozitave të Ligjit Nr.06/L-113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, përkatësisht nenit 18 paragrafi 1 dhe 3 ku përcaktohet se: 1. Sekretari i Përgjithshëm është nëpunësi në lartë civil i ministrisë, përgjegjës për drejtimin e të gjithë veprimtarisë administrativo-profesionale të sistemit ministror. 3. Sekretari i Përgjithshëm ka këto përgjegjësi kryesore: (...) 3.4. siguron drejtimin, koordinimin, kontrollin dhe mbikëqyrjen e të gjithë sistemit ministror; dhe dispozitave të Rregullores (QRK) Nr.01/2019 për Themelimin dhe Zbatimin e Funksonimit të Auditimit të Brendshëm në Subjektin e Sektorit Publik, përkatësisht nenin 10 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 ku përcaktohet se: 1. Udhëheqësi i subjektit të sektorit publik: 1.3. siguron zbatimin e rekomandimeve të pajtuara për auditimin e brendshëm sipas planit të veprimit, dhe po ashtu duke marrë parasysh se me dispozitat e nenit 59 paragrafi 4 të Rregullores (ZKM) Nr.01/2021 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës të Ministrisë së Punëve të Brendshme, Departamenti për Standarde dhe Politika të Inxhinieringut dhe Menaxhimit të Ndërtesave Qeveritare, përbëhet nga tri divizione: Divizioni i Planifikimit dhe Standardeve, Divizioni i Menaxhimit të Projekteve, dhe Divizioni i Menaxhimit të Ndërtesave Qeveritare, Kolegji i Këshillit vlerëson se Zyrtari Kryesor Administrativ, ashtu sikurse edhe ankuesi në cilësinë e drejtorit të DPSIMNQ-se, mbajnë përgjegjësi menaxheriale në lidhje në zbatimin e rekomandimeve të dhëna nga auditori, dhe rrjedhimisht neglizhenca e tyre në trajtimin e rekomandimeve, gjegjësisht kujdesi në sigurimin e zbatimit të rekomandimeve duhet të merret parasysh me rastin e vlerësimit të performances, ndërsa përgjegjësia e drejtpërdrejtë bie mbi personat përgjegjës të caktuar në Planin e Veprimit të Menaxhmenti të Subjektit të Sektorit Publikë. Në kuptim të kësaj, Kolegji i Këshillit konstaton se Komisioni Disiplinor në lidhje me këtë çështje ka dështuar të zbatoj drejtë dhe në mënyrë të plotë gjendjen faktike, sepse nga shkresat e lëndës gjegjësisht Plani i Veprimit të Menaxhmentit, nuk është gjetur se ankuesi është i ngarkuar drejtpërdrejtë si person përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve të Raportit të Auditimit.

Komisioni Disiplinor, me Vendimin me Nr.579/2022 të datës 08.04.2022, po ashtu ka konstatuar se ankuesi është përgjegjës edhe për shkak të neglizhencës në trajtimin e kërkesave të eproreve/mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë si dhe ato të institucioneve tjera që bien në fushëveprimin e DSPIMNQ-së, respektivisht; Kërkesën lidhur me gëlqerosjen e kabinetit në Ministrinë e Industrisë, Ndermarresisë dhe Tregtisë (MINT); Kërkesën për servisim dhe furnizim me kondicionerë për Institucionin e Avokatit të Popullit, Adresimin me kohë të çështjes për

mirëmbajtjen e objektit "Rilindja"; si dhe Kërkesës për ngrohje në Ministrinë për Komunitet dhe Kthim. Ndërsa ankuesi në ankesën e tij të parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, thekson se çdo kërkesë e pranuar në DSPIMNQ, është trajtuar dhe adresuar menjëherë në Divizionin për Menaxhimin e Ndërtesave. I njëjti thekson se Komisioni Disiplinor nuk ka marr parasysh faktin se DSPIMNQ është e sterngarkuar me kërkesa ku vetëm gjatë vitit 2021 ka pranuar 5807 kërkesa për të cilat ka dhënë përgjigje të gjitha Institucioneve të Republikës së Kosovës.

Në lidhje me konstatimin e Komisionit Disiplinor, Kolegji i Këshillit duke ju referuar provave të administruara të lëndës, gjegjësisht Kërkesës të datës 01.04.2021 të [redacted] zyrtar i MINT-it, dhe rrjedhimisht e-mailit të datës 06.04.2021 të [redacted] asistente e Sekretarit të Përgjithshëm të MPB-së, drejtuar ankuesit; Kërkesës të datës 23.08.2021 të [redacted] zyrtar i Institucionit të Avokatit të Popullit, si dhe kërkesën e datës 07.10.2021 të z.Jashar Kastrati, Sekretar i Përgjithshëm në Isntucionin e Avokatit të Popullit, drejtuar ankuesit, ka konstatuar se në lidhje me realizimin e këtyre dy kërkesave, gjegjësisht kërkesës për gëlqerosje të kabinetit në Ministrinë e Industrisë, Ndermarresisë dhe Tregtisë, dhe kërkesës për servisim dhe furnizim me kondicionerë për Institucionin e Avokatit të Popullit, ka pasur neglizhencë të dukshme në përmbushje të detyrave të punës nga DSPIMNQ, dhe rrjedhimisht përgjegjës për këtë neglizhencë në realizimin e këtyre kërkesave është edhe ankuesi, sepse i njëjti në shumicën e rasteve ka qenë i njoftuar e në disa raste mbikëqyrësi i tij ka kërkuar drejtpërdrejtë nga ankuesi të ndërmerren veprime në drejtim të realizimit të kërkesave. Andaj, Kolegji i Këshillit vlerëson se Komisioni Disiplinor, ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike në lidhje me konstatimin se ankuesi ka shpërfaqur neglizhencë në realizimin e këtyre dy kërkesave, gjegjësisht kërkesës për gëlqerosje të kabinetit në Ministrinë e Industrisë, Ndermarresisë dhe Tregtisë, dhe kërkesës për servisim dhe furnizim me kondicionerë për Institucionin e Avokatit të Popullit, sepse në të dy rastet, kërkesat janë realizuar pas një periudhë kohore për me shumë se tre muaj. Ndërsa, lidhur me mungesën e ngrohjes në Ministrinë për Komunitet dhe Kthim, Kolegji i Këshillit ka gjetur se ankuesi me datë 07.10.2021 ka dërguar kërkesë të vartësit e tij në lidhje me realizimin e kërkesës, dhe po ashtu i njëjti me datë 20.10.2021 ka kërkuar nga vartësit e tij që të veprohet me pro aktivitet, dhe si rrjedhojë me datë 15.11.2021 janë njoftuar se është lëshuar ngrohja në ndërtesën e Ministrisë për Komunitet dhe Kthim, andaj, Kolegji i Këshillit duke ju referuar shkresave të komunikimit, vlerëson se ankuesi ka vepruar menjëherë në raport me realizimin e kësaj kërkesë dhe se nuk vërehet ndonjë neglizhencë në realizimin e kërkesës, kështu që Komisioni Disiplinor, nuk ka konstatuar drejtë gjendjen faktike në lidhje me kërkesën për ngrohje në Ministrinë për Komunitet dhe Kthim, dhe gabimisht ka zbatuar ligjin material me rastin e shpalljes së ankuesit përgjegjës në lidhje me këtë çështje.

Kështu që pas analizimit të shkresave të lëndës si dhe të gjeturave të pasqyruara si në arsyetimin e këtij vendimi, Kolegji i Këshillit, konstaton se Komisioni Disiplinor pranë Ministrisë së Punëve të Brendshme, me Vendimin Nr.579/2022 të datës 08.04.2022 ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike me rastin e konstatimit se ankuesi është përgjegjës lidhur me çështjen e aprovimit të raportit të komisionit të negocimit pa aprovim paraprak nga Zyrtari Kryesor Administrativ, si dhe lidhur me konstatimin se ankuesi ka shpërfaqur neglizhencë në realizimin e dy kërkesave, gjegjësisht kërkesës për gëlqerosje të kabinetit në Ministrinë e Industrisë, Ndermarresisë dhe Tregtisë, dhe kërkesës për servisim dhe furnizim me kondicionerë për Institucionin e Avokatit të Popullit, dhe drejtë ka zbatuar ligjin material duke shpallur përgjegjës ankuesin për shkelje disiplinore nga neni 46 paragrafi 1, 2 nën paragrafi 2.1 dhe paragrafi 3 nën paragrafi 3.3 të Ligji Nr.06/L-114 për

Zyrtarët Publikë. Ndërsa, Kolegji i Këshillit vlerëson se Komisioni Disiplinor nuk ka vërtetuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë gjendjen faktike dhe rrjedhimisht nuk ka zbatuar drejtë ligjin material me rastin e konstatimit se ankuesi është përgjegjës në lidhje me parregullsitë në procedurat e prokurimit për mirëmbajtje higjienike të iniciuara nga Departamenti për Standarde dhe Politika të Inxhinieringut dhe Menaxhimit të Ndërtesave Qeveritare, gjegjësisht tejkalimin e afateve në realizimin e aktiviteteve, ashtu sikurse edhe lidhur me çështjen e menaxhimit të kontratave publike të ndërtimit dhe zbatimin e rekomandimeve të Njësisë së Auditimit të Brendshëm, për arsytet e dhëna si me lartë.

Andaj, meqenëse nga administrimi i provave është gjetur se Komisioni Disiplinor nuk ka arritur të vërtetoj përgjegjësinë e ankuesit lidhur me parregullsitë në procedurat e prokurimit për mirëmbajtje higjienike, gjegjësisht tejkalimin e afateve në realizimin e aktiviteteve, si dhe lidhur me çështjen e menaxhimit të kontratave publike të ndërtimit dhe zbatimin e rekomandimeve të auditimit të brendshëm, si dhe duke marr parasysh faktin se ankuesi sipas shkresave të lëndës nuk ka masa tjera disiplinore të mëparshme të pashlyera, Kolegji i Këshillit vlerëson se masa disiplinore "Largim nga Shërbimi Civil" është masë e rëndë dhe si e tillë nuk është në proporcion me shkeljet e konfirmuara sipas këtij vendimi.

Kështu që Kolegji i Këshillit pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës dhe duke u bazuar në dispozitat e nenit 46 paragrafi 1, paragrafi 2 nën paragrafi 2.1 dhe paragrafi 3 nën paragrafi 3.3, nenin 47 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3, dhe nenin 50 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, si dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 dhe paragrafi 2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi të aprovoj pjesërisht si të bazuar ankesën, dhe si rrjedhojë të ndryshoj masën disiplinore për ankuesin, nga masa disiplinore "Largim nga Shërbimi Civil", në masën disiplinore "Ndalimi i ngritjes në detyrë, duke përfshirë këtu rritjen në shkallën e pagës për një periudhë prej tri viteve", si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.432/2022

Avdyl BEKTESHI

Procesmbajtës



Vendimi i dërgohet

- Përfaqësuesit të autorizuar të ankuesit
- Sekretarit të Përgjithshme të Ministrisë së Punëve të Brendshme;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Punëve të Brendshme; dhe
- Arkivot të KPMSHCK-së.